REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS



PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN

2025 - 2030

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR MIGRACIONIN DHE DIASPORËN 2025-2030

BASHKIA HAS

Plani Vendor i Veprimit për Migracionin dhe Diasporën për Bashkinë Has 2025- 2030 u hartua nga:

Grupi i punës

1. Hanife Cahani	*Specialiste për Koordinimin Evropian, Migracionin dhe Diasporën*
2. Erisa Ferizolli	*Përgjegjëse e Sektorit Juridik*
3. Grislanda Bajraktari	*Përgjegjëse e Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore*
4. Emirela Kurpali	*Specialiste Komunikimi*
5. Bukurosh Onuzi	*Ekspert i Jashtëm, Bashkia Has*

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË-
BASHKIA HAS

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTIMEVE 4
LISTA E TABELAVE 4
HYRJE 5
METODOLOGJIA 6
KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR DHE KOMBETAR 8
PLANET VENDORE TË BASHKISË HAS 15
PROFILI I BASHKISË HAS 19
PERSPEKTIVA GJINORE 22
ANALIZA PESTEL 24
QËLLIMI DHE VIZIONI 29
OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR HAS 31
FUSHA E VEPRIMIT A 32
FUSHA E VEPRIMIT B 33
FUSHA E VEPRIMIT C 36
FUSHA E VEPRIMIT D 39
MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT 40

-REPUBLIKA E SHQIPËRISË-
BASHKIA HAS

LISTA E SHKURTIMEVE

ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKD	Agjencia Kombëtare e Diasporës
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e VetëqeverisjesVendore
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BH	Bashkia Has
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DHBD	Dhoma e Biznesit të Diasporës
DKM	Departamenti i Kufirit dhe i Migracionit
GCM	Kompakti Global për Migracionin
GIZ	Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
MB	Ministria e Brendshme
MPV	Ministria për Pushtetin Vendor
INSTAT	Instituti i Statistikave
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
SDG	Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SM	Sportel Migracioni
SMD	Struktura e Migracionit dhe Diasporës

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Analiza PESTEL 24
Tabela 2: Objektivat e Planit Vendor Has 31
Tabela 3: Fusha e Veprimit A 31
Tabela 4: Fusha e Veprimit B 34
Tabela 5: Fusha e Veprimit C 37
Tabela 6: Fusha e Veprimit D 39

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

HYRJE

Hartimi i Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën në Bashkinë Has u realizua nga grupi i punës së stafit të bashkisë Has. Ky plan është bazuar në legjislacionin kombëtar kuadër, si dhe në udhëzimet për planifikimin e territorit të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Plani është hartuar bazuar në nevojat që autoritetet vendore kanë lidhur me ndryshimet e fundit që pësoi ligji Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar. Për këtë arsye, ky plan vendor është një vlerë e shtuar e bashkisë Has, për të përmirësuar qeverisjen vendore duke përfshirë dhe migracionin e diasporën në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve dhe projekteve që kanë të bëjnë me ta. Ndryshimet e ndodhura në ligjin për vetëqeverisjen vendore në vitin 2015 dhe në vitin 2019, adresojnë nevojën për hartimin e këtij plani duke përcaktuar dhe shtuar detyrat dhe funksionet e bashkive në lidhje me diasporën dhe migracionin, nëpërmjet thellimit të përgjegjësive të pushtetit lokal për këto çështje. Më konkretisht Bashkia ka detyrat si më poshtë:

a) Krijimi i një strukture të specializuar për menaxhimin e shërbimeve të diasporës dhe migracionit në nivel lokal, si pjesë e administratës së njësisë së vetëqeverisjes vendore;

b) Inkurajimi i organizimeve brenda dhe jashtë vendit për të ruajtur komunikimin dhe forcimin e lidhjeve me diasporën dhe emigrantët shqiptarë;

c) dhënien e ndihmës e të informacionit për proçesin e fitimit të shtetësisë shqiptare;

d) Furnizimi me ndihmë dhe informacion për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni rreth legjislacionit shqiptar për investimet, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për investimet;


e) Koordinimi me ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme, të jashtme dhe për diasporën për sigurimin e ndihmës dhe informacionit për çështjet lidhur me diasporën dhe migracionin.

Nëpërmjet këtyre masave dhe politikave, synohet të krijohen struktura funksionale dhe politika të përshtatshme për menaxhimin e migracionit dhe statusit të diasporës shqiptare në botë, duke thelluar ndërveprimin e tyre në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Kjo synon dhe përfshirjen e diasporës në procesin e planifikimit të nivelit lokal dhe hartimin e një manuali me objektiva dhe masa strategjike për këtë qëllim, duke përcaktuar rolin e aktorëve të interesuar në fushën e migracionit dhe diasporës.

METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën në Bashkinë Has është ndërtuar mbi parime gjithëpërfshirëse dhe të mirëkoordinuara, duke përfshirë disa faza kryesore që synojnë të adresojnë në mënyrë efektive sfidat dhe mundësitë në fushën e migracionit dhe diasporës.



Këto faza janë:

A. Analiza e nevojave dhe potencialit të komunitetit për të identifikuar sfidat dhe mundësitë që kanë lidhje me migracionin dhe diasporën, si dhe të përcaktohen nevojat specifike të Bashkisë Has nëpërmjet:

   - Mbledhjes së të dhënave pranë Agjencive Rajonale të Punësimit dhe Aftësive dhe informacionit pranë institucioneve publike respektive. Analiza bazohet në identifikimin e nevojave dhe ndërlidhja me shërbimet e ofruara nga pushteti vendor.

B. Vlerësimi i kapaciteteve institucionale dhe të burimeve njerëzore në nivel bashkie për trajtimin e çështjeve të migracionit dhe diasporës.

C. Rishikimi i dokumenteve ekzistuese: Analiza e dokumenteve dhe politikave vendore dhe kombëtare për të kuptuar situatën aktuale të migracionit.

D. Analiza e praktikave më të mira: Përdorimi i shembujve ndërkombëtarë dhe kombëtarë për kthimin dhe riintegrimin e migrantëve.

Zhvillimi i Kuadrit Ligjor dhe Strategjik për të siguruar përputhshmërinë e planit me kuadrin kombëtar dhe ndërkombëtar ligjor dhe strategjik për migracionin dhe diasporën nëpërmjet:

Rishikimit të politikave kombëtare dhe ndërkombëtare: Përshtatja e këtyre politikave në nivel lokal për të zhvilluar një plan të qëndrueshëm.

Identifikimi i detyrimeve ligjore: Reflektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kuadri ligjor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

ekzistues, duke përshtatur këto elemente në politikat lokale.

Zhvillimit të objektivave të qarta dhe të matshme për të arritur rezultate të prekshme nëpërmjet:

Definimit të objektivave: Vendosja e objektivave për kthimin e migrantëve, përfshirjen e diasporës në zhvillimin e bashkisë dhe forcimin e kapaciteteve lokale.


Zhvillimit të një plani të veprimit: Përcaktimi i aktiviteteve specifike dhe përgjegjësive për zbatimin e planit, duke përfshirë palët lokale dhe kombëtare.

Zhvillimi i kapaciteteve të stafeve lokale për të siguruar një zbatim efektiv të planit përmes forcimit të kapaciteteve lokale konkretisht nëpërmjet:

Trajnimeve për zyrtarët lokalë: Sesione trajnimi për stafin e bashkisë në lidhje me migracionin, diasporën, dhe zhvillimin ekonomik.

Organizimi i sesioneve të trajnimit për përfaqësuesit lokalë të Bashkisë Has ka si qëllim përmirësimin e aftësive, rritjen e kapaciteteve dhe njohurive të tyre në lidhje me hartimin dhe zbatimin efektiv të objektivave të planifikuara. Këto aktivitete janë të domosdoshme për të siguruar një qasje të koordinuar dhe të qëndrueshme në menaxhimin e burimeve dhe në arritjen e rezultateve të dëshiruara.

Metodat e përdorura:



Krijimi i një grupi pune të dedikuar për hartimin dhe konsultimin e planit, me përbërje nga specialist të migracionit dhe diasporës, specialist për çështjet juridike dhe specialist të kostimit dhe buxhetit në nivel bashkie.

Diskutime dhe mbledhja e informacionit në grupe nga institucionet publike në nivel vendor për të dakortësuar fushat e veprimit, objektivat dhe masat.

Konsultimi i Planit Vendor të Veprimit me bashkitë e tjera si Kukësi dhe Dibra, të cilat janë pilotuar në vitin 2021 për hartimin e Planeve Vendore për migracionin dhe diasporën.

Në fund, është ndjekur procedura e konsultimit publik të Planit Vendor të Veprimit për migracionin dhe diasporën për të siguruar pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në procesin e hartimit të planit.

KONTEKSTI NDËRKOMBËTAR DHE KOMBËTAR

Në spektrin ndërkombëtar Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm në fushën e migracionit duke adoptuar Marrëveshjen Globale për Migracionin (GCM) në dhjetor 2018, gjatë Konventës Ndërqeveritare në Marrakesh, e cila synon të lehtësojë lëvizjen e sigurt të migrantëve dhe të maksimizojë përfitimet që ata sjellin. Qeveria shqiptare ka integruar GCM-në në politikat e saj të migracionit dhe ka dorëzuar një raport vlerësimi për periudhën 2019-2021, po ashtu ka hartuar raporte për rishikimin rajonal dhe kombëtar të GCM-së në vitet 2020 dhe 2022, duke e vlerësuar anëtarësimin në Bashkimin Evropian si një prioritet kyç për zhvillimin e vendit.

Përmes **Strategjisë Kombëtare për Migracionin (SKM)** dhe Planit të Veprimit 2024-2030, Shqipëria synon të përmirësojë koherencën ndërmjet politikave dhe të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm, shtuar faktin që Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) ofron udhëzime të vazhdueshme për zbatimin e GCM-së, duke nënvizuar lidhjen me SKM-në. Në këtë kontekst, një nga sfidat kryesore vazhdon të mbetet promovimi i kthimit vullnetar të migrantëve, që konsiderohet një mënyrë efektive për të parandaluar migrimin e të kualifikuarve. Kthimi dhe riintegrimi i të miturve të pashoqëruar dhe të kthyerve në rrethana të cenueshme janë gjithashtu detyra të rëndësishme, me qëllim për të parandaluar keqpërdorimin e regjimit pa viza dhe për të ulur kërkesat për azil në Bashkimin Evropian, janë të nevojshme masa urgjente dhe konkrete. Një prioritet tjetër është përmirësimi i infrastrukturës për menaxhimin e flukseve të migracionit, duke krijuar hapësira adekuate për të miturit, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikimit ku Ministria e Brendshme, përmes Drejtorisë së Politikave te Migracionit dhe Antitrafikut, është e angazhuar për të informuar vazhdimisht institucionet dhe aktorët e tjerë të rëndësishëm. Për të përmirësuar zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit (2024-2030), është e rëndësishme që të krijohen mekanizma efektivë për konsultime të rregullta me palët e interesuara. Këto konsultime do të ndihmojnë në identifikimin e nevojave dhe sfidave që hasin ata që kërkojnë strehim dhe mbështetje, duke u siguruar që zëri i tyre të dëgjohet dhe të merret parasysh në procesin e vendimmarrjes.

Duke u mbështetur në parimet e Kompaktit Global për Refugjatët, Shqipëria duhet të angazhohet për të forcuar bashkëpunimin me vendet e tjera dhe me organizatat ndërkombëtare, për të siguruar një ndarje të drejtë të barrës dhe përgjegjësisë në trajtimin e krizave të migracionit. Iniciativat për rritjen e kapaciteteve të institucioneve përkatëse dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për refugjatët dhe migrantët do të jenë thelbësore. Kjo do të përfshijë trajnimet për punonjësit e shërbimeve sociale, ofrimin e mbështetjes psikologjike dhe sociale,

si dhe integrimin e refugjatëve në komunitetet lokale. Angazhimi i Shqipërisë në Forumin e Parë Global të Refugjatëve në 2019, dhe përfshirja e vazhdueshme për të adresuar sfidat e migracionit, tregon se vendi është në rrugën e duhur për të ndihmuar ata që janë në nevojë dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre. Me një qasje të koordinuar dhe proaktive, Shqipëria mund të shërbejë si një model në menaxhimin e migracionit dhe mbështetje të refugjatëve në nivelin rajonal dhe ndërkombëtar.

Në përgjigje të kësaj në shkurt të 2021, qeveria shqiptare miratoi një **ligj të ri për azilin,** i cili shënon një hap të rëndësishëm drejt përafrimit të sistemit të azilit me standardet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian. Ky ligj parashikon zhvillimin e një mekanizmi nga Ministria e Brendshme për vlerësimin e proceseve të azilit dhe përmirësimin e cilësisë së procedurave, duke bashkëpunuar ngushtë me UNHCR. Një aspekt kyç i këtij procesi është organizimi i trajnimeve për zyrtarët e azilit në bashkëpunim me EUAA, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe efektivitetit në trajtimin e kërkesave për azil. Për më tepër, strategjia e Bashkimit Evropian për Kthimin Vullnetar dhe Riintegrimin, e publikuar në prill 2021, thekson rëndësinë e krijimit të një sistemi të përbashkët për menaxhimin e kthimeve dhe riintegrimeve vullnetare të migrantëve. Kjo strategji fokusohet në forcimin e shërbimeve publike në vendet e origjinës, përfshirë kujdesin shëndetësor dhe mundësitë për punësim, duke e bërë riintegrimin më të suksesshëm. Bashkëpunimi ndërkombëtar, angazhimi i shoqërisë civile dhe përfshirja e sektorit privat janë thelbësore për arritjen e këtyre objektivave. Agjencia Frontex po ashtu është angazhuar të mbështesë këtë proces, duke dërguar oficerë ndërlidhës në vendet e treta për të organizuar ripranimin e migrantëve dhe për të ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve vendore.

Qeveria shqiptare ka shprehur angazhimin e saj për të harmonizuar politikat kombëtare me ato të BE-së përmes **Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030.** Kjo strategji përfshin prioritete për migracionin që përputhen me paktin e BE-së, me një fokus të veçantë në tërheqjen e migrantëve shqiptarë dhe lehtësimin e riintegrimit të tyre. Gjatë Samitit të Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor, u diskutua gjithashtu për Planin e Veprimit të BE-së, i cili përmban 20 masa operacionale për forcimin e menaxhimit të kufijve, procedurat e shpejta të azilit dhe luftimin e kontrabandës së migrantëve. Qeveria shqiptare ka integruar këto masa në Strategjinë Kombëtare të Migracionit dhe Planin e Veprimit 2024-2030, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit rajonal për menaxhimin e migracionit të sigurt dhe të rregullt.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë në vitin 2023 konfirmon se kuadri ligjor për

migracionin është gjerësisht në përputhje me acquis të BE-së, duke dëshmuar angazhimin e vendit për të përmirësuar sistemin e tij të menaxhimit të migracionit dhe për të siguruar një mbështetje efektive për ata që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Këto nisma përfaqësojnë një hap të rëndësishëm përpara në rrugën e Shqipërisë drejt integrimit në Bashkimin Evropian dhe ofrojnë një perspektivë më të mirë për migrantët dhe ata që kërkojnë azil. Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe BE-së për zbatimin e **Planit të Veprimit për Ballkanin Perëndimor** ka sjellë rezultate të dukshme. Shqipëria ka finalizuar një Marrëveshje të rishikuar me Frontex-in, duke përafruar 26 nga 29 aktet legjislative të nevojshme. Megjithatë, sfidat mbeten, sidomos në lidhje me kthimin e shtetasve të vendeve të treta, që është ende në nivele të ulëta. Policia e Kufirit dhe Migracionit ka nevojë të krijojë struktura trajnuese për identifikimin e grupeve vulnerabël dhe të forcojë koordinimin me departamentet e antitrafikut dhe mbrojtjes së fëmijëve. Në fushën e azilit, Shqipëria ka përafruar 15 akte legjislative, por konsultimet me EUAA vazhdojnë të mbeten thelbësore për përmirësimin e procesit. Rritja e kërkesave për azil nga shqiptarët në vendet e BE-së tregon nevojën për masa ri-integrimi, veçanërisht për ata që janë më në nevojë. Raporti gjithashtu evidenton progresin në lirinë e lëvizjes, me një rënie të refuzimeve në pikat kufitare.

Në aspektin e kuadrit kombëtar janë një sërë dokumentash strategjikë që përputhen dhe përkojnë më masat dhe objektivat e planit të veprimit si, Strategjia Kombëtare e Diasporës dhe Plani i Veprimit 2021-2025 që janë korniza strategjike për mbështetje ndaj shqiptarëve jashtë atdheut. Qëllimi kryesor është hartimi i politikave gjithëpërfshirëse për komunitetet shqiptare, duke siguruar angazhim dhe mbështetje ligjore. Strategjia promovon integrimin dhe kontributin e diasporës në zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë. Ajo synon të fuqizojë lidhjet mes shqiptarëve në mbarë botën dhe të ndihmojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve dhe vendit. Plani i veprimit përforcon politikën lokale për të krijuar një bashkëpunim të qëndrueshëm.

Një tjetër dokument që përkon me objektivat dhe masat e planit të veprimit është **Strategjia Kombëtare e Migracionit dhe Plani i Veprimit 2024-2030** synojnë të koordinojnë aktivitetet e institucioneve për të arritur objektivat e politikave migratore. Fokusohen në zhvillimin e politikave efektive që promovojnë ndikimin pozitiv të migracionit në zhvillimin socio-ekonomik. Dokumenti përfshin masa për lehtësimin e procedurave për leje unike, shërbime integrimi dhe riintegrim të emigrantëve. Rëndësi i jepet krijimit të mekanizmave koordinues në të gjitha nivelet e qeverisjes, sidomos në nivelin lokal.

Zbatimi i politikave gjithëpërfshirëse është thelbësor për maksimizimin e përfitimeve nga migracioni dhe ndikimin e qëndrueshëm në ekonomi, sakaq Strategjia Kombëtare e Punësimit 2023-2030 në Shqipëri adreson sfidat e punësimit përmes pesë qëllimeve kryesore si: reduktimi i mospërputhjeve të aftësive, rritja e niveleve të aftësive për të dyja gjinitë, përmirësimi i vlerave të punës, dixhitalizimi i mbështetjes për punësim dhe sigurimi i funksionimit të saktë dhe në kohë të masave. Ajo gjithashtu fokusohet në integrimin social dhe territorial, duke adresuar sfidat e migracionit dhe diasporës me një qasje të personalizuar. Kjo strategji ofron një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për të krijuar mundësi të reja punësimi dhe zhvillimi në Shqipëri.

Një dokument tjetër që korrespondon me qëllimet dhe masat e planit të veprimit është **Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021-2027** që thekson rëndësinë e diasporës shqiptare për rritjen ekonomike të vendit. Ajo nxit angazhimin e diasporës në aktivitete ekonomike dhe promovon nisma sipërmarrëse, duke krijuar një kuadër ligjor që lehtëson investimet. Qëllimi është forcimi i lidhjeve brenda komunitetit shqiptar dhe shfrytëzimi i potencialit të diasporës si burim për zhvillimin ekonomik. Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën synon krijimin e një ambienti miqësor për bashkëpunim dhe përmbushjen e nevojave lokale për investime nga diaspora.

Arsimi në Republikën e Shqipërisë menaxhohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas Strategjisë Kombëtare për Arsimin dhe Planit të Veprimit 2021-2026. Këto dokumente adresojnë sfidat e arsimit duke përcaktuar përgjegjësitë midis Ministrisë së Arsimit dhe njësive lokale të vetëqeverisjes vendore. Ato kanë rol të rëndësishëm në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës arsimore, veçanërisht në sistemin e arsimit parashkollor. Strategjia thekson mbështetje për fëmijët në rrezik, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe minoritetet. Po ashtu, në kuadër të planit për Migracionin dhe Diasporën, fokusohet në ofrimin e informacionit dhe mbështetje për rikthyerit dhe të huajt, për të lehtësuar integrimin e tyre në shoqëri. Një tjetër shërbim thelbësor që ofrohet në njësitë e vetëqeverisjes vendore është shërbimi shëndetësor.

Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030 synon të sigurojë zbatimin efektiv të nismave shëndetësore në nivel kombëtar përmes një bashkëpunimi të ngushtë me aktorë të ndryshëm, si ministritë dhe përfaqësuesit vendor. Kjo strategji ofron një kornizë të qartë për koordinimin dhe mbështetje për ata që përballen me sfida të veçanta, siç janë ata që rikthehen nga emigracioni dhe të huajt. Ajo garanton akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor në nivel

lokal, duke siguruar që çdo individ të ketë mundësi për të përfituar nga shërbimet e nevojshme. Në këtë mënyrë, strategjia kontribuon në një mirëqënie më të plotë të popullsisë, duke adresuar nevojat unike të grupeve të ndryshme dhe duke krijuar një sistem shëndetësor më të integruar dhe të aksesueshëm për të gjithë përfshirë të huajt që jetojnë në Shqipëri.

Ndërkohe një aspekt tjetër më largpamës thekson rëndësinë që ka **Strategjia Kombëtare për Zhvillimi dhe Integrim Europian 2022-2030** në Shqipëri paraqet një qasje gjithëpërfshirëse, e cila ndërtohet mbi sukseset e strategjisë së mëparshme (2015-2020). Ajo fokusohet në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe aspiratave për anëtarësim në Bashkimin Europian. Kjo strategji angazhon institucione të ndryshme, duke siguruar një koordinim të efektshëm në procesin e zhvillimit dhe integrimit të vendit. Gjithashtu, Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën synon të krijojë një sistem të fuqishëm qeverisjeje për menaxhimin e migracionit, duke adresuar sfidat përkatëse dhe duke theksuar rëndësinë e tij për zhvillimin kombëtar.

Pa dyshim, që rinia është e ardhmja e çdo kombi, dhe **Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029** synon të fuqizojë të rinjtë në Shqipëri, duke i inkurajuar ata të angazhohen aktivisht në shoqëri dhe në proceset vendimmarrëse. Kjo strategji përfshin politika të informuara dhe të mirëfinancuara, të cilat promovojnë mundësi arsimore dhe zhvillimin e aftësive në një kontekst global. Një fokus i veçantë i saj është adresimi i nevojave të grupeve vulnerabël, si studentët e huaj dhe ata që janë kthyer nga emigracioni. Qëllimi është të krijohet një kuadër gjithëpërfshirës që siguron zhvillimin dhe mirëqenien e të rinjve, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre aktive dhe integrimin në tregun e punës. Kjo do të kontribuojë në ndërtimin e një shoqërie më të fortë dhe më të qëndrueshme, ku çdo i ri ndjen se ka një rol të rëndësishëm në formësimin e të ardhmes së vendit të tij.

Një rëndësi të padiskutueshme ka **Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030** e cila paraqet një bazë të fortë për përmirësimin e qeverisjes vendore dhe ofrimin e shërbimeve më afër qytetarëve duke theksuar rëndësinë e njësive të vetëqeverisjes vendore në sigurimin e qeverisjes së mirë, duke përmirësuar shërbimet për komunitetet. Reforma administrative ka sjellë decentralizim të funksioneve, duke i lejuar bashkive të operojnë në mënyrë demokratike dhe të adresojnë nevojat specifike të komuniteteve të tyre. Qëllimi kryesor i strategjisë është konsolidimi i procesit të decentralizimit, me fokus në zhvillimin ekonomik lokal të qëndrueshëm, duke ofruar shërbime cilësore dhe transparente. Përmes rritjes së kapaciteteve për menaxhimin e aseteve,

digjitalizimit të shërbimeve dhe forcimit të autonomisë financiare, strategjia synon të përmirësojë efikasitetin e qeverisjes vendore. Plani i veprimit për Migracionin dhe Diasporën gjithashtu përfshin masa për të siguruar akses më të mirë në shërbime për grupet e cenueshme, duke integruar aspektet e migracionit në zhvillimin lokal, për të garantuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Një tjetër dokument është **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030** synon zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e jetesës për individët në nevojë, përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe grupe vulnerabël. Ajo promovon skema financiare të qëndrueshme për fuqizimin dhe integrimin e këtyre individëve përfshirë të huajtë. Strategjia fokusohet në qasjen e barabartë në shërbime sociale dhe zhvillimin e aftësive për integrim në tregun e punës. Masa konkrete mbështesin riintegrimin social-ekonomik, duke lidhur punësimin me promovimin e ndërmarrjeve sociale dhe janë në harmoni me planin për Migracionin dhe Diasporën.

Një rëndësi të vecantë, për vetë faktin se integrimi gjinor vazhdon të mbetet një çështje e nxehtë dhe e diskutueshme, paraqet dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 që është një iniciativë kyçe për promovimin e të drejtave të grave dhe reduktimin e diskriminimit gjinor. E hartuar në bashkëpunim me institucione të ndryshme, ajo fokusohet në garantimin e të drejtave ekonomike dhe sociale për të gjitha grupet, pa dallim gjinie. Strategjia inkurajon trajtimin e barabartë në shërbime dhe aksesin në teknologji, duke siguruar mundësi të barabarta për zhvillim ekonomik. Në kuadër të planit të veprimit për Migracionin dhe Diasporën, theksohet rëndësia e barazisë gjinore për fuqizimin e grave dhe vajzave, duke krijuar një ambient të drejtë për të gjithë individët në shoqëri.

Një aspekt tjetër që lidhet prek drejtpërsëdrejti nivelin lokal është dhe ***ligji për Vetëqeverisjen Vendore nr. 139/2015***, së bashku me ndryshimet e *ligjit nr. 38/2019*, ka sjellë një transformim të rëndësishëm në organizimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, duke u fokusuar në decentralizimin dhe efikasitetin e administratës publike. Një element thelbësor është angazhimi me diasporën dhe komunitetet e migrantëve, ku bashkitë tani kanë përgjegjësi të qarta për këto grupe. Struktura të posaçme adresojnë shqetësimet e të rikthyerve dhe emigrantëve, ofrojnë asistencë dhe informacion mbi legjislacionin e investimeve, si dhe krijojnë mundësi integrimi, duke forcuar lidhjet midis shqiptarëve brenda dhe jashtë vendit. Kjo kontribuon në forcimin e komuniteteve dhe promovimin e mirëqenies për të gjithë.

Një ligj që prek drejtpërdrejt kategorinë e të huajve në Shqipëri është ***"Ligji për Të Huajt" nr 79/2021***që është një dokument i rëndësishëm që rregullon mënyrën se si individët e huaj

hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga vendi. Ai përfshin aspekte kyçe si lëshimi i vizave dhe lejeve të qëndrimit, duke mbështetur parime themelore si interesi më i mirë i fëmijëve, uniteti familjar dhe mosdiskriminimi. Ky ligj zbatohet për të huajt që vijnë në Shqipëri për arsye punësimi, studimi ose qëndrimi, duke përcaktuar në mënyrë të qartë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe ato të autoriteteve përkatëse. Me avancimin e proçesit të dixhitalizimit, aplikimet për vizat dhe lejet e qëndrimit tani janë bërë më të thjeshta dhe më të aksesueshme, pasi mund të realizohen online. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për ata që hasin vështirësi për shkak të mungesës së misioneve diplomatike në disa vende. Gjithashtu, ligji përfshin nisma për integrimin e migrantëve, duke ofruar shërbime dhe programe arsimore që ndihmojnë ata në orientimin në sistemin institucional shqiptar. Kjo qasje e integruar jo vetëm që përmirëson aksesin në shërbime thelbësore, por gjithashtu nxit një integrim të suksesshëm të të huajve në shoqërinë shqiptare. Duke siguruar mbështetje dhe burime, ligji respekton të drejtat e njeriut dhe kontribuon në krijimin e një ambienti më mikpritës për të gjithë ata që zgjedhin Shqipërinë si vend të tyre të ri.

Duke u mbështetur në njohuritë e marra nga shtyllat e mëparshme, shtylla e tretë fokusohet në zhvillimin e një plani gjithëpërfshirës objektivash dhe masash konkrete. Kjo përfshin sintetizimin e gjetjeve nga analiza e nevojave dhe ekzaminimi i kuadrit ligjor dhe strategjik për të formuluar objektiva konkrete dhe masa të zbatueshme. Në këtë mënyre duke përcaktuar objektiva të qarta dhe masa, synohet të sigurohet një udhërrëfyes për adresimin e nevojave të identifikuara dhe shfrytëzimin efektiv i potencialit të grupit të synuar për zhvillimin socio-ekonomik. Përmes analizës së kontekstit dhe vizitave në terren, është krijuar një përmbledhje e situatës dhe gjendjes faktike në këtë Bashki. Hartimi dhe konsultimi i Planeve Lokale është realizuar përmes përpjekje bashkëpunuese me grupin punës për të hartuar një dokument sa më të qartë dhe të zbatueshëm. Këto plane përfshijnë objektiva të matshëm, aktivitete konkrete dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Plani i Përgjithshëm Vendor

Në linjë me dokumentet strategjike kombëtare, Plani i Përgjithshëm Vendor identifikon zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të Hasit, nëpërmjet zhvillimit të sektorëve të ndryshëm për rritjen e ekonomisë lokale. Plani parashikon që Hasi dhe Hasjanët të kenë një zhvillim të qëndrueshëm, të begatë, të sigurtë, të shëndetshëm dhe të prekshëm nga të gjithë. Banorët e Hasit nga të gjitha anët dhe shtresat shoqërore do të kenë të siguruar një akses të plotë me shërbime publike, mundësi më të mëdha punësimi dhe kushte cilësore banimi. Atraksionet e shumta natyrore dhe historike të shfrytëzohen me eficencë të plotë, duke bërë të lulëzojë ekonomia agrare, bizneset dhe qendrat turistike.

Plani Vendor për Barazinë Gjinore (PVBGJ)

Plani Vendor për Barazinë Gjinore (PVBGJ) i Bashkisë Has për periudhën 2025–2030 është një dokument strategjik dhe operativ që synon të promovojë barazinë midis grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës sociale, ekonomike dhe politike në nivel vendor. Hartimi i këtij plani është në përputhje me angazhimet ligjore dhe politike të Shqipërisë për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut.

Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2030 përmban në themel të tij vizionin ***për një Has ku gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, si dhe vajzat dhe djemtë, pavarësisht moshës, nevojave të veçanta, grupit etnik e social, përkatësisë fetare, orientimit seksual apo identitetit të tyre gjinor, trajtohen sipas parimit të barazisë dhe drejtësisë gjinore, në të gjitha fushat e jetës***.

Plani fokusohet në këto fusha prioritare:

- **Rritja e pjesëmarrjes së grave në jetën politike dhe vendimmarrëse lokale.**
- **Fuqizimi ekonomik i grave dhe mbështetja për gratë sipërmarrëse, veçanërisht në zonat rurale.**
- **Parandalimi dhe trajtimi i dhunës me bazë gjinore.**
- **Përmirësimi i shërbimeve sociale me fokus në barazinë gjinore.**
- **Ndërtimi i kapaciteteve institucionale për integrimin gjinor.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Disa nga objektivat specifike të planit përfshijnë:

- Rritjen me 30% të numrit të grave në pozita drejtuese në administratën vendore deri në vitin 2030;
- Mbështetjën me grante ose trajnime të paktën 50 grave për nisma ekonomike ose bujqësi;
- Realizimin e fushatave ndërgjegjësuese kundër dhunës në familje në çdo njësi administrative të Bashkisë Has;
- Përmirësimin e të dhënave gjinore për monitorimin e politikave vendore.

Zbatimi dhe Monitorimi: Zbatimi i planit do të bëhet nga strukturat përkatëse të bashkisë, në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe aktorë të tjerë lokalë.

Plani Social i Bashkisë Has 2024-2027

Dokumenti i Planit të Mbrojtjes Sociale (PMS) i Bashkisë Has 2024-2027 i shërben jo vetëm si pjesë e përqasjes strategjike për zhvillimin e Bashkisë në tërësi, por edhe si një nevojë për një qeverisje të mire dhe demokratike, për të përmbushur përgjegjësinë ndaj qytetarëve për shërbime sociale të përshtatshme. Ky dokument është baza mbi të cilën mbështeten iniciativat e Bashkisë, shoqërisë civile, dhe ofrueseve publik dhe privat të shërbimeve sociale, për zgjidhjen e problemeve sociale të individëve, familjeve dhe komuniteteve në nevojë. Plani Mbrojtjes Sociale është bazuar në qasjen e ofrimit të një paketë shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore dhe rajonale, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Në këtë bashki Plani i Mbrojtjes Sociale adreson të gjithë problematikat për grupet vunerabël dhe në këtë prizëm mund të adresohen edhe problematikat që përfshijnë nevojat e migrantëve të kthyer dhe të mundshëm. Në zbatim të vizionit dhe politikave për mbështetjën e qytetarëve, Plani i Mrojtjes Sociale Bashkia Has 2024 – 2027 përfshin masat që synojnë adresimin e problemeve, si më poshtë:

A. Përmirësimi i përformancës së stafit të Bashkisë Has

- Kjo masë fokusohet në fushën e shërbimeve sociale përmes identifikimit të nevojave për trajnime të specializuara dhe rishikimit të strukturës së sektorit të dhe mbrotjes sociale dhe ndihmës ekonomike për të siguruar një efikasitet dhe koordinim më të mirë të burimeve njerëzore ku përfshihet ngritja e strukturës të njësive të vlerësimit nevojave dhe referimit (NJVNR)

B. Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale në Bashkinë Has

- Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale në Bashkinë Has duke ndërthurur pagesat në cash me shërbime shoqërore për të siguruar një qasje të përmirësuar dhe më efikase të ndihmës së ofruar për familjen dhe individin në nevojë."

C. Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit në Bashkinë Has

- Rritja e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrjes aktive të komunitetit në Bashkinë Has përmes organizimit të fushatave të informimit, takimeve të hapura dhe platformave të konsultimeve për të inkurajuar qytetarët të marrin pjesë aktivisht në hartimin dhe zbatimin e politikave sociale.

D. Zbutja e papunësisë përmes ofrimit të kurseve profesionale, të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me nevojat lokale

- Nëpërmjet kësaj mase synohet të kualifikohen personat e papunë përmes pjesëmarrjes në kurse profesionale në bashkëpunim me shkollën profesionale, Zyrën Vendore të Punësimit dhe OJF-ve. Edukimi professional ndikon jo vetëm për zvogëlimin e largimit të fuqisë puntore jashtë vendit por edhe për punësimin e partnereve femra, të cilat partnerët e tyre kanë emigruar jashtë vendit.

Plani i Integritetit 2022-2025

Plani i Integritetit paraqet një mekanizëm të rëndësishëm për forcimin e integritetit institucional. Ky plan është një dokument strategjik dhe operacional që është produkt i procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në Bashkinë Has. Vlerësimi ka përfshirë të gjitha proceset e punës sipas fushave të veprimit të bashkisë dhe funksionet/pozicionet e punës të cilat janë më së shumti të ekspozuara ndaj veprimeve korruptive, sjelljeve joetike, joprofesionale dhe parregullsive të tjera.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Puna për hartimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Has është bazuar në analizën e të dhënave dhe punën kërkimore të zhvilluar. Plani i Integritetit është përgatitur nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës me personelin e bashkisë dhe është mbështetur në informacionin, sugjerimet dhe propozimet e ekipit të ekspertëve të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim në lidhje me zbatimin e Dokumentit të Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.


Ky plan synon realizimin e objektivave të mëposhtëm:

- Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator në aspekte të veçanta të etikës dhe integritetit;
- Menaxhimi dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në bashki, për identifikimin dhe parandalimin e risqeve të integritetit;
- Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun;
- Menaxhimi i riskut të integritetit në fusha të veçanta të përgjegjësisë së bashkisë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

PROFILI I BASHKISË HAS

Bashkia Has e pozicionuar në veri-lindje të Shqipërisë, është një zonë me karakteristika rurale dhe bujqësore, ku sipas censusit të vitit 2023 numëron një popullsi prej 11.684 banorësh, ndërsa sipas Rregjistrit të Gjendjes Civile bashkia ka një popullsi prej 21.764 banorësh. Bashkia e



Hasit përbëhet nga një 4 Njësi Administrative (Krumë, Fajzë, Gjinaj, Golaj) 1 qytet dhe 29 fshatra. Qendra e bashkisë është Kruma e shpallur qytet në vitin 1972 dhe ka sipërfaqe prej 393 km². Hasi është një krahinë etno-gjeografike me kufij të përcaktuar shumë qartë, i rrethuar pothuajse rreth e qark i gjithë Hasi me lumenjë ku në mes ngrihet madhështor mali i Pashtrikut me lartësi 1989 m mbi nivelin e detit. Në veri dhe lindje, Drini i Bardhë dhe Dega e tij Ereniku që e ndajnë nga krahina e Rekës dhe Podrimës (Rrafshi i Drinit). Në jug dhe në perëndim dhe sot liqeni i Fierzës, ndërsa në veri-perëndim përroi i Skatinës e ndan nga Bytyçi i rrethit të Tropojës etj.

E pozicionuar në kufi me Kosovën, Hasi përfaqëson një zonë me pozitë gjeografike të vlerësueshme nga ana e mundësisë për zhvillimin e marrëdhënieve ndërkufitare me impakt në tregti dhe ekonomi. Pika kufitare me Kosovën (Qafë Prush) është një nga lidhjet më të rëndësishme ndërkombëtare, që favorizon dhe lehtëson levizjen mes të dy vendeve, duke qenë një korridor i rëndësishëm tregtar. Përmes rrugëve që kalojnë nëpër Qaf Prush, ka akses të shpejtë drejt qyteteve të Kosovës, si Prizereni dhe Gjakova.

Në aspektin ekonomik, ekonomia e Hasit është kryesisht rurale, e mbështetur në bujqësi, blegtori dhe tregti ndërkufitare me Kosovën. Këto sektorë përbëjnë burimet kryesore të të ardhurave për popullsinë lokale. Tregtia ndëkufitare ka krijuar mundësi për shkëmbimin e produkteve bujqësore dhe të konsumit. Disa banore të Hasit shfrytezojnë këtë afërsi për të kryer aktivitete tregtare në Kosovë, si dhe për të importuar dhe eksportuar mallra. Pra, bizneset kryesore që mbështesin ekonomine e Hasit janë: bujqësia dhe blegtoria, tregtia ndërkufitare, dyqanet dhe shërbimet e vogla, transporti dhe logjistika, dhe remitancat nga diaspora. Këto sektore krijojnë punësim dhe të ardhura për komunitetin lokal. Gjithashtu ekonomia bazohet në ekonominë familjare të fermave të vogla bujqësore dhe blegtorale, me një tendencë në rritje.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Rrethi i Hasit përbëhet nga shkëmbinj gëlqeror, magmatike dhe metamorfike çka shpjegon pasuritë e shumta minerare në këtë zonë, veçanërisht kromë dhe bakër. Minierat e kromit dhe bakrit në këtë rajon kanë qenë aktive në të kaluarën dhe megjithëse aktivitet minerare janë zbehur, ato mbeten një burim i vlefshëm natyror. Përveç mineraleve metalike, në Has ka edhe depozita minerale jometalike që përdoren në industrinë e ndërtimit, si p.sh. gëlqerorët dhe argjilat. Sasia më e madhe e kromit njihet në Vlahen. Sipas studimeve, ne Golaj gjenden rreth 4.5 milion ton rezerva bakër të pashfrytëzuara edhe për shkak të mosfunksionimit të minierës. Fshatrat Vranisht, Vlahën dhe Cahan njihen për nëntokë të pasur me Fe-Ni.

Hasi është një zonë me potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit rural dhe kulturor për të cilin po punohet për ta ngritur në nivelet e duhura. Male, lumenjë, dhe pyje të dendur ofrojnë një peisazh të bukur që mund të tërheqë turistë të interesuar në ecje, kamping dhe eko-turizëm. Qyteti i Hasit ka 7 hotele, 11 restaurante dhe 57 bare, duke ofruar një gamë të gjerë opsionesh për akomodim dhe shërbime gastronomike për banorët dhe vizitorët. Gjithashtu, zona ka një histori dhe kulturë të pasur që mund të promovohet për tërhequr turistë kulturorë, me përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe promovimin e pikave turistike. Potencialet e larta turistike me burimet e shumta natyrore, vlerat e mëdha kulturore dhe historike dhe kulinaria tradicionale, janë elementë që e pasurojnë turizmin Hasjan. Përmendim bujtinat që po marin një hov këtë periudhë, falë sistemit rrugor që është në përmirësim e sipër, i cili padyshim do të sjellë një zhvillim të madh ekonomik në këtë rajon. Rijetësimi i Muzeut është një nga pikat kyçe dhe prioriteti numër një i turizmit, historisë dhe kulturës Hasjane. Bashkia e Hasit me qëllim promovimin e zonës, të vlerave kulturore, turistike e artizanale, organizon aktivitete në mënyrë periodike. Dita e Gurbetqarëve që mendohet të realizohet për herë të parë për t'u kthyer pastaj në rutine si një aktivitetet më gjithëpërfshirëse, pasi kësaj feste do i bashkohen migrantët dhe diaspora Hasjane.

Në këtë mënyrë bëhet e mundur promovimi dhe ruajtja e lidhjeve shpirtërore me ta, por edhe ndikon drejtpërdrejtë në tërheqjen e tyre për investime dhe zhvillime të bizneseve të ndryshme në rajon. Festa të tjera që zhvillohen në qytetin e Hasit janë: Dita e Qytetit, Plegrinazh në Malin e Pashtrikut, Panairi me produkte bujqësore, blektorale dhe artizanale, Dita e Verës, Dasma Hasjane etj. E me gjithë aktivitetet dhe degët e ekonomisë, familjet Hasjanë më së shumti mbahen nga remitancat, ku emigrimi ka qenë dhe mbetet baza kryesore e të ardhurave sidomos për familjet në zonat rurale. Kjo gjë tregon qartazi numrin e lartë të emigrantëve, por duke mos

përjashtuar dhe diasporën. Megjithatë, vlen të thekohet që këto remintanca përvec së ndikimit të drejtpërdrejtë në mirëqënien e familjeve, nuk janë përdorur në mënyrë të gjerë për investime strategjike që do të krijonin punësim të qëndrueshëm dhe zhvillim ekonomik afatgjatë në Has. Ky rast përbën një shëmbull të sukseshëm për tërheqjen e emigrantëve dhe diasporës me qëllim investimin e tyre në këtë zonë, zhvillimin e ekonomisë, ndërtimin e bizneseve të hotelerisë, bujtinave dhe shërbimeve të ndryshme.

Në një vështrim të përgjithshëm, të kthyerit që janë bashkuar me familjet e tyre referuar arsyes së kthimit nga vendet e mëparshme të qëndrimit, mbizotërohen nga arsyet familjare dhe më pak nga arsyet e punësimit. Struktura e re e bashkisë, me funksionin e shtuar për diasporën dhe migracionin, si dhe ky plan do të shërbejnë më së miri për ruajtjen e lidhjeve me migrantët dhe diasporën e zonës, me destinacion bërjen e tyre faktor kryesor të bashkisë Has, duke i ndihmuar për të investuar në degë të ndryshme të ekonomisë, me qëllim zhvillimin ekonomik e social të bashkisë Has.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

[1] **Anketa Kombëtare e Migracionit në Familje në Shqipëri**, 2020, faqe 28, 35, 45
http://ëëë.instat.gov.al/media/7969/zhvillimi_i_anket%C3%ABs_komb%C3%ABtare

PERSPEKTIVA GJINORE

Përkatësia Gjinore në Çështjet e Migracionit dhe Diasporës

Migracioni dhe diaspora nuk janë vetëm fenomene ekonomike apo demografike, por procese që ndikojnë drejtpërdrejt në marrëdhëniet shoqërore, struktura familjare dhe barazinë gjinore. Për këtë arsye integrimi i përspektivës gjinore në planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve të migracionit është një element i domosdoshëm për të kuptuar përvojat e ndryshme që përjetojnë burrat dhe gratë. Perspektiva gjinore në çështjen e migracionit dhe diasporës përfaqëson një qasje të rëndësishme që eksploron sesi rolet tradicionale gjinore, normat kulturore dhe struktura sociale ndikojnë në përvojat dhe vendimet e individëve që migrojnë. Migracioni nuk është një përvojë uniforme; ajo ndryshon në mënyrë të theksuar sipas gjinisë, duke formuar ndryshe sfidat dhe mundësitë për burrat, gratë dhe individët me identitete gjinore të ndryshme.

Tradicionalisht, burrat kanë qenë aktorët kryesore të migracionit, shpesh të shtyrë nga nevoja për të gjetur mundësi pune dhe për të siguruar të ardhura për familjen. Ndërkohe, gratë kanë mbetur pas në vendin e origjinës, duke marrë përsipër kujdesin për familjen, rritjen e fëmijëve dhe mbajtjen e lidhjeve shoqërore. Megjithatë, ky model i ndarjës së roleve ka ndryshuar ndjeshëm gjatë dekadave të fundit. Sot, numri i grave që emigrojnë është rritur ndjeshëm. Ata shpesh udhëtojnë si kryefamiljare, duke marrë mbi vete përgjegjësi të plota ekonomike dhe sociale për familjen. Ky transformim ka sjellë ndryshime të rëndësishme në strukturat shoqërore dhe në mënyrën si shihen rolet gjinore, duke theksuar gjithnjë e me shumë nevojën për politika të barazisë gjinore. Pavarësisht nga kjo rritje e pjesëmarrjes së grave në migracion, përvoja e tyre shpesh mbetet e karakterizuar nga pabarazia dhe diskriminimi.

Gratë migrante janë më të prekshme ndaj trafikimit të qënieve njerëzore, abuzimeve seksuale, shfrytëzimit në tregun e punës dhe dhunës fizike e psikologjike. Në shumë raste, ato përballen me një mungesë të qasjes në shërbime shëndetësore, edukative dhe mbrojtje ligjore, kryesisht për shkak të mungesës së dokumentacionit të ligjshëm ose frikës nga abuzimet. Nga ana tjetër, burrat përballen me presione të tjera, shpesh të ndërlidhura me pritshmëritë tradicionale që lidhen me rolin e tyre si "mbajtësit e familjes". Ata mund të përballen me sfida të rënda në tregun e punës, shpesh duke u përfshirë në sektorë me rrezik të lartë dhe paga të ulëta. Për burrat, migracioni mund të nënkuptojë edhe izolim shoqëror dhe mungesë të mbështetjës emocionale, pasi normat tradicionale shpesh i pengojnë të kërkojnë ndihmë. Migracioni sjell transformime të dukshme në strukturat gjinore dhe në marrëdhëniet familjare. Kur gratë

migrojnë, ato shpesh fitojnë më shumë autonomi dhe rol vendimmarrës brenda familjes. Kjo ndikon jo vetëm në jetën e tyre, por edhe në normat shoqërore të komunitetit të origjinës, duke krijuar modele të reja të organizimit familjar sic është ndryshimi i normave tradicionale në shoqërinë e origjinës së tyre por edhe në përplasjen që mund të ndeshen për shkak se ndryshimet në një kulturë nuk janë të lehta për t'u përballur.

Në diasporë, ndarja gjinore reflektohet në mënyrën e përfshirjes sociale dhe ekonomike. Gratë shpesh kontribuojnë në ekonomitë e vendeve pritëse në sektorë të nënvlerësuar nga shoqëria pritëse si puna në shtëpi, kujdesi dhe shërbimet, ndërsa burrat në sektorët e punës fizike, që shpesh karakterizohen nga rrezikshmëri dhe paga të ulëta. Diaspora mund të ofrojë një hapësirë për ndërtimin e solidaritetit midis grave, si edhe midis burrave, ashtu sikurse edhe midis dy gjinive me njëra tjetrën, duke krijuar rrjete mbështetjëje për të ndihmuar njëra-tjetrën të përballen me sfidat e përditshme të jetës së migrantëve.

Në këtë kuadër, perspektiva gjinore zbulon sesi gratë dhe burrat e prekur nga migracioni përjetojnë në mënyra të ndryshme problemet dhe sfidat që lindin nga vendimi për të lëvizur. Kjo qasje e thellë dhe gjithëpërfshirëse i fton profesionistët dhe politikat publike të përqendrohen në njohjen e nevojave dhe përvojave unike të individëve, duke e bërë kështu proçesin e hartimit të politikave më të ndjeshëm ndaj gjinisë. Në këtë kontekst, punonjësit socialë luajnë një rol të rëndësishëm në identifikimin e sfidave specifike që hasin grupet e ndryshme, duke ofruar një mbështetje të personalizuar dhe duke promovuar zgjidhje që respektojnë diversitetin e përvojave njerëzore. Politikat migratore gjithashtu duhet të jenë të ndjeshme ndaj këtyre dinamikave, duke u siguruar që çdo individ, pavarësisht nga gjinia, të ketë akses në mbështetje dhe mbrojtje të përshtatshme. Kjo do të thotë që strategjitë e migracionit duhet të përfshijnë aspekte të ndryshme, si mbrojtja nga dhuna dhe shfrytëzimi, si dhe promovimi integrimit dhe mundësive për zhvillim personal dhe profesional. Bashkia, si institucioni më i afërt me qytetarët, ka një rol kyç në procesin e integrimit dhe mbështetjës së individëve që kthehen ose migrojnë në një zone të re. Ajo duhet të shërbejë si pika e parë e kontaktit për ata që kthehen ose vendosen në një zonë të re, duke u ofruar informacion, asistencë dhe orientim për të kaluar me sukses proçedurat administrative dhe sociale. Një plan veprimi për migracionin dhe diasporën është mëse i nevojshëm për të adresuar nevojat specifike të grupëve të ndryshëm brenda shoqërisë. Ky plan nuk mund të kuptohet plotësisht pa një analize gjinore, pasi burrat dhe gratë përballen me sfida dhe mundësi të ndryshme në kontekstin e migracionit. Kjo qasje gjinore në menaxhimin e migracionit është thelbësore për të siguruar që nevojat dhe përvojat e të gjithë individëve të merren parasysh. Një komunitet që

integron në mënyrë të barabartë burrat dhe gratë është një komunitet më i fortë, më rezilient dhe më i aftë të përballoje sfidat e zhvillimit modern.

ANALIZA PESTEL

Analiza e mëposhtme PESTEL është zhvilluar nga grupi i punës që përgatitën Planin Vendor për Migracionin dhe Diasporën në Bashkinë Has për periudhën 2025-2030. Analiza bazohet në informacionin e dhënë nga Bashkia Has, kërkimet dhe të dhënat e gjeneruara nga diskutimet. Në këtë kontekst, të dhënat janë mundësuar në bashkëpunim me autoritetet vendore dhe stafin e Bashkisë Has. Evidencat bazohen në faktorët politik, ekonomik, socio-kulturor dhe teknologjikë. Njëkohësisht, ndikimi i faktorëve specifikë në zhvillimet në Bashki u vlerësua në një shkallë me tre faza dhe parashikimi i faktorëve me vlerësimin pozitiv, nuk ka ndryshim dhe negative. Më poshtë, gjendet Tabela 1 me të dhënat e gjeneruara për Bashkinë Has.

Tabela 1: Analiza PESTEL

FAKTORËT	Fuqia e ndikimit në zhvillimin e bashkisë	Parashikimi i drejtimit të ndikimit të faktorëve
FAKTORËT POLITIK		
Stabiliteti Politik	3	↑
Shpërndarja strukturore e fondeve të BE	2	↑
Bashkëpunimi ndërkombëtar	1	↑
Mbështetja për zhvillimin rajonal	1	↑
Taksat Vendore	1	↑
Niveli i decentralizimit	1	↑
Rregulloret mjedisore	1	→
Kapacitetet e burimeve njerëzore në nivel vendor	3	↑
Zhvillimi i partneritetit publik privat	2	↑
FAKTORËT EKONOMIKË		
Gjendja e ekonomisë	1	↑
Dinamika e rritjes ekonomike	1	↑
Varësi nga remitancat	2	↑
Zhvillimi i industrisë së turizmit	3	↑

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Ndikimi dhe niveli i investimeve të huaja	1	↑
Vendndodhja gjeografike	3	↑
Konkurrenca nga njësitë e tjera territoriale	3	↓
Cilësia e politikës ekonomike qendrore	3	↑
Niveli mesatar i të ardhurave	1	↑
Shkalla e papunësisë dhe mungesë investimesh vendore nga diaspora në sektorë prioritarë (bujqësi, turizëm rural)	3	↓
FAKTORËT SOCIAL-KULTURORË		
Roli i burrave dhe grave në shoqëri	3	↑
Emigracioni i punëtorëve të kualifikuar	3	↓
Imigrimi i punëtorëve të pakualifikuar	3	↓
Pabarazitë sociale	2	↓
Zbrazje demografike dhe plakje e popullsisë	3	↓
Fondet për kujdesin shëndetësor dhe social	1	↑
Shkalla e rritjes së popullsisë	1	↑
Humbje e trashëgimisë kulturore te brezat e rinj në emigracion	1	↓
Identiteti lokal	2	↑
FAKTORËT TEKNOLOGJIKË		
Zhvillimi i infrastrukturës së transportit (teknik).	2	↑
Zhvillimi i mediave sociale	3	↑
Zhvillimi i inovacionit	1	↑
Akses në teknologjitë moderne	2	↑

Legjenda e Tabelës

Fuqia e ndikimit:

- 3-e lartë;
- 2-mesatare;
- 1-e ulët

Parashikimi i drejtimit:

- pozitive↑;
- ska ndryshim→;
- negative↓

REPUBLIKA E SHQIPËRISË- BASHKIA HAS

Në Bashkinë Has, **stabiliteti politik dhe kapacitetet e burimeve njerëzore** në nivel vendor konsiderohen dy faktorët politik me ndikimin më të madh. Stabiliteti politik parashikohet se ndikon pozitivisht në procesin e vendimarrjes si dhe rritja e kapaciteteve njerëzore rrit cilësinë e shërbimeve.

Ndër faktorët me ndikim mesatar por parashikohet rëndësi në rritje listohen shpërndarja strukturore e fondeve të Bashkimit Evropian dhe zhvillimi i partneritetit publik privat. Nëpërmjet tërheqjes së fondeve parashikohet ofrim shërbimesh konkrete dhe më cilësor. Po ashtu bashkëpunimi me bizneset private për politikat e migracionit dhe diasporës vlerësohet si frytdhënës për të ardhmen. Vëmendje e veçantë i duhet dhënë bashkëpunimit ndërkombëtar, mbështetjës për zhvillim rajonal, taksave vendore, nivelit të decentralizimit dhe rregullores mjedisore pasi listohen ndër faktorët e zhvillimit të Bashkisë me ndikim të ulët por parashikohet efekt pozitiv sepse ndikojnë në zhvillimin e bashkisë dhe përmirësimin në një numër aspektesh siç janë rritja e fondeve, rritja e instrumenteve për implementimin e praktikave më të mira, taksa më të ulëta për të nxitur investimet, politika më të mira për mjedisin etj. Duhet theksuar se nuk ka patur më parë një iniciativë konkrete për riintegrimin e emigrantëve të kthyer apo kategorive të tjera.

Bashkia e Hasit është në hapat e para të këtyre iniciative për shkak se është një nëvoje për t'u përmirësuar që ka kohë që ka lindur. **Çështjet e migracionit dhe diasporës** kanë qenë gjithmonë një problematikë për Bashkinë Has dhe për rrjedhojë është e nevojshme hartimi dhe marrja e masave konkrete për menaxhimin e sfidave të migracionit dhe diasporës me efikasitet.

Gjithashtu, Bashkia e Hasit ka bashkëpunuar vazhdimisht me Organizata të ndyshme lokale, kombëtare apo ndërkombëtare në shumë fusha të tjera sociale por nuk ka pasur asnjëherë projekt për migracionin dhe diasporën. Evidentohet nevoja për mbështetje nga ekspertë të huaj dhe projekte gjithëpërfshirëse për adresimin efektiv të çështjeve të migracionit dhe diasporës. Për më tepër është e rëndësishme të nënvizohet fakti se Bashkia Has ka nevojë për një database për migrantët dhe diasporën. Përsa i përket bashkëpunimit me organizatat lokale, vlen të theksohet fakti se janë të specializuara në fusha sociale të ndryshme por nuk janë të specializuara për të dhënë shërbime në fushën e migracionit dhe diasporës. Disa organizata që Bashkia ka bashkëpunuar janë Perspektiva të Reja, ADAD, Center for youth Progress, Eden Center etj. Si dhe disa prej organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare që Bashkia Has ka bashkëpunuar janë UNDP, ACPD, UNICEF, UNICED, TIKA etj.

Ndër faktorët ekonomik me ndikim më të madh listohen **vendndodhja gjeografike,**

konkurrenca nga njësitë e tjera territoriale, cilësia e politikës ekonomike në nivel qendror dhe shkalla e papunësisë dhe mungesë investimesh vendore nga diaspora në sektorë prioritarë (bujqësi, turizëm rural). Pozita gjeografike kufitare me Kosovën, e cila mundëson zhvillimin e ekonomisë, nëpërmjet shkëmbimeve tregtare dhe projektëve ndërkufitare (cross-border) dhe cilësia e politikës ekonomike në nivel qendror parashikohet të sjellë ndikim pozitiv duke e lidhur me aspektin klimatik dhe politikat për mbështetje me fonde apo investime për zhvillim të mëtejshëm të zonës. Siç dhe evidentohet zhvillimi në Bashki është i lidhur ngushtë me situatën ekonomike në nivel kombëtar dhe rajonal. Gjithashtu vëmendje i duhet dhënë faktorëve me ndikim të lartë si zhvillimi i industrisë së turizmit rural dhe bujqësisë, të cilat parashikohet se ndikojnë pozitivisht pasi në zonë ka potencial për zhvillimin e turizmit dhe përthithje të emigrantëve për të investuar në vendlindje. Turizmi është një nga faktorët prioritarë për rritjen ekonomike dhe investimet do i jepnin një tjetër dimension zhvillimit të turizmit. Kryesisht, emigrantët që kthehen investojnë në fushën e turizmit ku hapin bare, restorante, bujtina etj, bazuar në zanatet që kanë marrë jashtë vendit dhe operojnë si raste suksesi pas kthimit. Gjithashtu janë planifikuar të ngrihen disa Info Point në disa pika kryesore të qytetit për turistat dhe vizitorët e huaj.

Faktorët me ndikim më të ulët vlerësohen **gjendja e ekonomisë, dinamikat e rritjes ekonomike,** gjendja e financave publike, tendencat ekonomike të brendshme, niveli investimeve të huaja dhe niveli mesatar i të ardhurave por parashikohet se rritja e gjendjes ekonomike, përmirësimi i dinamikave ekonomike dhe tendencave ekonomike të brendshme ndikon pozitivisht në planin afatgjatë. Po ashtu, duhet theksuar se niveli i investimeve të huaja është i ulët por parashikohet ndikim pozitiv nëse në Bashkinë Has do të ketë invetime nga të huajt duke ndikuar në rritje e punësimit dhe cilësisë të shërbimeve por edhe do ndikojë në rritjen e konkurencës.

Një numër i konsiderueshëm **faktorësh social-kulturorë vlerësohen** me ndikim të madh për zhvillimin e Bashkisë Has si roli i burrave dhe grave në shoqëri, emigracioni i puntorëve të kualifikuar, imigrimi i punëtorëve të pakualifikuar, zbrazja demografike dhe plakja e popullsisë. Roli i burrave dhe grave në shoqëri parashikohet se ka ndikim pozitiv për barazinë gjinore, zhvillimin personal dhe professional të komunitetit. Ndërsa emigracioni i puntorëve të kualifikuar, imigrimi i puntorëve të pakualifikuar, zbrazja demografike, plakja e popullsisë dhe humbja e trashegimisë kulturore te brezat e rinj në emigracion vlerësohet se do të kenë efekt negativ edhe në të ardhmen. Gjithashtu, Bashkia ka nevojë për **informacione** me shifra të sakta për emigrimin e puntorëve të kualifikuar,dhe imigrimin e punëtorëve të pakualifikuar për të

adresuar nevojat dhe shqetësimet kryesore jo vetëm për imigrantët por edhe për të huajt që jetojnë në këtë zonë në mënyrë që të mundësohet aksesimi në shërbime shëndetësore, arsim, apo tregun e punës. Në këtë Bashki nevojiten të dhëna për karakteristikat demografike kryesore të të huajve, imigrantëve si dhe të rikthyerve që banojnë në njësitë administrative të kësaj Bashkie siç janë mosha, gjinia, origjina etnike, gjendja civile, arsimi, dhe përvoja e punës.

Për më tepër, faktorët me ndikim mesatar listohen identiteti lokal, që vlerësohet që do ndikojë pozitivisht, ndërsa pabarazitë sociale vlerësohet se do të ndikojë negativisht. Dy faktorë tjerë me ndikim por që duhet kushtuar vëmëndje janë fondet për kujdesin shëndetësor dhe social si dhe shkalla e rritjes së popullsisë. Politikat për nxitjen e lindshmërisë dhe përmirësimin e kujdesit shëndetësor dhe social ndikojnë drejtpërdrejt pozitivisht në standardin e jetesës tek qytetarët.

Përsa i përket **faktorëve teknologjikë**, fokusi primar është në zhvillimin e mediave sociale, pasi ka ndikim më të lartë dhe aksesohet lehtësisht. Për rrjedhim ka efekt pozitiv të menjëhershëm në shpërndarjen e informacionit dhe mundëson komunikimin e shpejtë dhe në kohë reale me migrantët dhe diasporën. Faktorë me efekt mesatar janë; **zhvillimi i infrastrukturës dhe aksesi në teknologjinë moderne**, ndikimi i të cilave parashikohet pozitiv por ka mungesë të theksuar të infrastukturës dhe duhet përditësim me zhvillimet teknologjike. Faktorë me ndikim të ulët është; zhvillimi i inovacionit për të cilën nevojitet vëmendje e shtuar për të ndjekur trendin në rritje në fushat e teknologjisë dhe inovacionit. Për këtë faktorë parashikohet ndikim pozitiv por nuk ka investime dhe vëmendje për të ndjekur kërkesat teknologjike të kohës. Vlen të theksohet se në këtë zonë, teknologjia nuk ka mundur akoma të ndjekë zhvillimet më të fundit inovative si një burim lehtësues për zhvillim të mëtejshëm dhe është i nevojshëm fokusi për investime në aspektin teknologjik.

Si një zonë me potencial për zhvillim të mëtejshëm por dhe për të tërhequr kthimin në vendlindje të të larguarve përfshirja e Diasporës dhe Migrantëve në vendimarrje dhe zhvillimin e politikave aktualisht mundësohet kryesisht nëpërmjet rrjetet sociale, duke luajtur një rol të rëndësishëm në komunikim midis Bashkisë Has dhe qytetarëve të diasporës. Ata mund të shkruajnë në faqen zyrtare të Bashkisë Has në Facebook dhe Instagram për problematikat dhe shqetësimet e tyre. Gjithashtu në procesin e hartimeve të Projekt Buxhetit të bashkisë dhe në eventet që publikohen në këto faqe ata mund të shprehin sygjerimet e tyre.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

QËLLIMI I PLANIT VENDOR

Qëllimi i Planit Vendor për Migracionin dhe Diasporën, është që të krijojë dhe fuqizojë infrastrukturën e nevojshme për qeverisjen efektive, koordinimin ndërinstitucional dhe orientimin e duhur të diasporës dhe migracionit, duke i bërë faktorë të rëndësishëm në zhvillimin social- ekonomik vendor. Bashkia Has synon të sigurojë mundësi të barabarta për qytetarët e saj, pavarësisht vendodhjes së tyre, punon për nxitjen e gjithëpërfshirjes dhe integrimin me të drejta të plota dhe të barabarta të qytetarëve të saj.

Përmes këtij plani bashkia ka si mision "të krijojë struktura të përshtatshme në lidhje me migracionin dhe diasporën duke vendosur fokusin tek ofrimi i shërbimeve dhe lehtësirave në realitetin ekonomiko-social". Për të arritur këtë, është e nevojshme një menaxhim i përmirësuar i burimeve vendore, një planifikim strategjik më i fuqishëm, forcimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale të administratës vendore, si dhe rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendim-marrëse. Në thelb, qeverisja e mirë dhe zhvillimi i qëndrueshëm janë objektivat kryesore që pushteti vendor duhet të sigurojë për mirëqenien dhe përparimin e komunitetit lokal.

VIZIONI I PLANIT VENDOR TË MIGRACIONIT DHE DIASPORËS

Në një botë gjithnjë e më të globalizuar, përfshirja e komunitetit të migracionit dhe diasporës në politikën socio-ekonomike dhe kulturore është thelbësore për ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme dhe të barabartë. Vizioni ynë është të krijojmë një ambient gjithëpërfshirës ku çdo qytetar i jonë, ka mundësi të barabarta për të kontribuar dhe përfituar nga zhvillimi i vendit të tij. Kjo përfshirje do të realizohet përmes politikave që inkurajojnë integrimin social, mbështesin iniciativat ekonomike dhe promovojnë ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe identitetit lokal të komuniteteve të migracionit. Qëllimi ynë është të ndihmojmë në forcimin e lidhjeve mes diasporës dhe vendit amë, duke bërë të mundur që ata të kontribuojnë aktivisht në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë, ku diversiteti festohet dhe respektohet, dhe ku çdo individ ndjen se zëri i tij ka rëndësi.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS



Bashkia Has 2025-2030

"Të forcojmë lidhjen me diasporën dhe të kthejmë migracionin në një mundësi zhvillimi për Hasin, duke krijuar një mjedis që nxit rikthimin, investimin dhe ruajtjen e identitetit kulturor", nëpërmjet bashkëpunimit të qëndrueshëm, dhe përfshirjes aktive të emigrantëve në jetën socio-ekonomike-kulturore të komunitetit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR HAS

Bashkia Has synon të adresojë detyrat funksionale dhe ligjore për çështjet e diasporës dhe migracionit, në mënyrë që të arrijë objektivat e parashikuara ne 4 fusha veprimi si më poshtë:

Tabela 2: Objektivat e Planit Vendor Has

Fusha A. Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor.	
Objektivat	A.1 Forcimi dhe përmirësimi i organizimit dhe funksionimit të strukturave vendore në menaxhimin e diasporës dhe migracionit. A.2 Rritja e kapciteteve dhe trajnimi i vazhdueshëm i specialistëve në njësitë vendore që trajtojnë çështjet e migracionit dhe diasporës. A.3 Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e rikthyer.
Fusha B. Shërbimet sociale publike me bazë komunitare.	
Objektivat	B.1 Edukimi dhe informim i qëndrueshëm në lidhje me të drejtat dhe detyrimet. B.2 Sigurimi i shërbimeve sociale për përfshirjen dhe rintegrimin e migrantëve të kthyer dhe komuniteteve të diasporës.
Fusha C. Zhvillimi dhe rritja e potencialit ekonomik të komunitetit lokal.	
Objektivat	C.1 Identifikimi dhe shpërndarja e nevojave vendore të komunitetit për investime me diasporën dhe migrantët. C.2 Sigurimi i ndihmës për të përmirësuar investimet publike dhe private nga komunitet i diasporës dhe migrantët e kthyer
Fusha D. Veprimtaritë kulturore dhe artistike.	
Objektivat	D.1 Promovimi i kontributit dhe vlerave të diasporës në fushën artistike dhe kulturore të vendit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Për realizim sa më efektiv, fushat e veprimit kanalizojnë problematikat dhe proceset e tjera të veprimtarisë së bashkisë në objektiva, të cilat përkthehen në masa konkrete të matshme, të realizueshme dhe të monitorueshme.

FUSHA E VEPRIMIT A

Menaxhimi institucional i diasporës dhe migracionit përbën një komponent të rëndësishëm në politikën dhe zhvillimin lokal. Ai realizohet nëpërmjet veprimit në tre drejtime kryesore që përfshin organizimin funksional të strukturave vendore, rritjen e kapaciteteve profesionale të specialistëve të njësive vendore dhe koordinimit të aktiviteteve me institucionet e pushtetit qendror dhe organizata të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare në mënyrë që të realizohet një lidhje e qëndrueshme me komunitetet e diasporës. Forcimi dhe organizimi funksional i strukturave përgjegjëse për menaxhimin e diasporës dhe migracionit, do të orientojë këtë proçes në përputhje me nevojat e komunitetit dhe prioritetet kombëtare. Elementët kyç në këtë menaxhim përfshin rritjen dhe trajnimin e stafit dhe forcimin e njohurive të tyre në fushën e migracionit dhe diasporës, për t'i mundësuar atyre që të ofrojnë shërbime efektive dhe mbështetje për individët dhe familjet që janë pjesë e këtyre grupeve. Një element i rëndësishëm janë dhe komunikimet e vazhdueshme me strukturat Qëndrore për migracionin dhe Diasporën, në mënyrë që të përfshihen në trajnime, takime të ndryshme, për të diskutuar nga afër vështirësit që këto struktura hasin në menaxhimin e rasteve dhe adresimin e nevojave që burojnë për këtë kategori si dhe monitorimin e implementimit të masave që duhen marrë. Për të siguruar një funksionim të mirë të strukturave, është e nevojshme hartimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës dhe procedurave standarde të punës për trajtimin e rasteve të migrantëve dhe diasporës për personat përgjegjës në fushën e migracionit dhe diasporës. Këto përshkrime do të ndihmojnë në qartësimin e detyrave dhe përgjegjësive, duke garantuar një menaxhim më efikas të burimeve si dhe të sigurojnë një qasje të unifikuar dhe të sistematizuar. Prodhimi i materialeve informuese dhe promovuese për strukturën vendore të migracionit dhe diasporës, takime me përfaqësues të institucioneve publike, private dhe organizatave të shoqërisë civile, do të krijojnë mundësi për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni që është gjithashtu i domosdoshëm. Këto materiale do të informojnë komunitetin për shërbimet dhe mbështetjën që ofrohen, duke kontribuar në ndarjen e informacionit të nevojshëm për individët e prekur. Do të paraqiten projekt ide nga programe të ndryshme dhe nga vet diaspora, apo të sjella edhe nga OJQ për të siguruar mbështetje të qëndrueshme dhe të efektshme për ata që rikthehen nga migracioni.

Tabela 3: **Fusha e Veprimit A**

Fusha e veprimit A.	**Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit:**					
Organizimi dhe koordinimi institucional i diasporës dhe migracionit në nivel vendor.	Fuqizim i strukturave menaxheriale institucionale për diasporën dhe migrantët.					
	Masat	**Periudha e zbatimit**	**Institucioni përgjegjës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultatet e pritshme**	**Indikatorët e monitorueshëm**
Objektivi 1.1: Forcimi dhe përmirësimi i organizimit dhe funksionimit të strukturave vendore në menaxhimin e diasporës dhe migracionit.	a) Hartimi dhe miratimi i përshkrimit të punës për personat përgjegjës në strukturën e migracionit dhe diasporës.	2025 - 2026	Sektori Burimeve Njerëzore, BH	MB MCPV Organizata	Përshkrimi i punës i aprovuar	1 akt
	b) Hartimi dhe miratimi i procedurave standarte të punës për trajtimin e rasteve te migrantëve dhe diasporës.	2025 - 2028		MB MCPV Organizata	Procedura të aprovuara	1 vendim
	c) Nxitja e shkëmbimit të përvojave më të mira dhe risive në menaxhimin e diasporës dhe migracionit me vendet e rajonit	2025 - 2027		MB MCPV Organizata AKD	Realizimi i vizitave studimore	Nr i vizitave studimore. Nr i përsonave që kanë marrë pjesë nga Bashkia Has. Foto nga vizita
	d) Prodhimi i materialeve informuese për rritjen dhe promovimin e Strukturës vendore të Migracionit dhe Diasporës	2025 - 2026		MB MCPV Organizata	Realizimi i materialeve promovuese dhe informuese për shërbimet që ofron struktura	Deri në 2500 kopje

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

Objektivi 1.2: Rritja e kapciteteve dhe trajnimi i vazhdueshëm i specialistëve në njësitë vendore që trajtojnë çështjet e migracionit dhe diasporës.	a) Organizimi i takimeve me qëllim ndarje eksperincash dhe informacioni me institucionet publike, private, organizatat e shoqërisë civile.	2025 - 2028		MB Organizata	Kalendar periodik i takimeve	Nr i takimeve dhe rezultatet e arritura
	b) Shkëmbimi periodik i informacionit midis NJQV dhe Sekretariatit Teknik të Migracionit për implementimin e masave që kanë përgjegjësi bashkia në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2030.	2025 - 2028	BH	MB	Raportime në afate kohore mbi updatete të dhënave disponuese dhe raporteve tek MB	Nr.i raportimeve E-mailet e shkëmbyera;
	c) Pjesëmarrja në trajnime , workshope për çështjet e migracionit dhe diasporës dhe hartimi i nje kalendari trajnimesh.	2025 - 2030	SMD/BH, Sektori i Burimeve Njerëzore	MB ASPA , OSHC Organizata	Kalendari i trajnimeve	Nr i trajnimeve; Nr i specialisteve të trajnuar. Çertifikatat e pjesëmarrjeve në trajnime.
	d)Organizimi i trajnimeve dhe workshopeve më strukturat e Bashkisë të ngarkuara me detyra që prekin fushën e migracionit dhe diasporës.	2025 - 2030		Organizata	Kalendar periodik i takimeve	Nr i takimeve /organizimeve
Objektivi 1.3: Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme me komunitetet e diasporës dhe emigrantët e rikthyer.	a) Organizimi i ndonje tryezë konsultuese së Bashkisë me komunitetin e diasporës.	2025 - 2030	BH	AKD, MB	Rritja e identifikimit të diasporës	Nr. i takimeve konsultative
	b) Krijimi i Këshillit Konsultativ të Diasporës dhe Migracionit	2025 - 2028	BH/Këshilli Bashkiak	AKD, MB	Adresimi i ideve të diasporës në politikat lokale	Akti i ngritjes së këshillit
	c)Krijimi i një bazë të dhënash për organizatat e diasporës dhe emigrantët dhe pasurimi i kësaj baze me të dhëna.	2025 - 2028		AKD AKPA Organizata	Databazë e plotë me të dhëna në bashkëpunim me OJF që veprojnë në diaspore.	1-Vlera bazë 0 2-Matet nga 0

d) Zbatimi i programeve dhe projekteve të bashkepunimit ndërmjet Bashkisë dhe OJF-ve.	2025 - 2028	BH	Organizata AKD		
e) Krijimi dhe ruajtja e një database të dhënash të qytetarëve të rikthyer nga migracioni	2025 - 2028	BH	NJAV/AKPA/ DSHC/OSHC	Një database me të dhëna në bashkëpunim me administrator të e Njësive Vendore dhe Shërbimin Social	Tabela me të dhënat statistikore të grumbulluara.

FUSHA E VEPRIMIT B

Shërbimet sociale publike me bazë komunitare janë një instrument esencial për të mbështetur migrantët dhe komunitetet e diasporës. Edukimi dhe informimi në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre, si dhe siguria e shërbimeve sociale për riintegrimin, janë hapa të rëndësishëm në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Synimi kryesor është të sigurohet një komunikim dhe informim i vazhdueshëm për diasporën dhe migrantët e rikthyer, për të ndihmuar në integrimin dhe riintegrimin e tyre në komunitetin lokal. Një aspekt kyç i këtyre shërbimeve është edukimi dhe informimi i qëndrueshëm në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e individëve. Migrantët shpesh përballen me barrierat e informacionit dhe pasigurinë ligjore, që vështirëson aksesin në shërbime esenciale si shëndetësia, arsimi dhe mbështetje sociale. Prandaj, ofrimi i informacionit të qartë dhe të saktë rreth të drejtave të tyre është thelbësor për t'u siguruar që ata të mund të shfrytëzojnë plotësisht mundësitë që u ofrohen. Kjo do të arrihet duke zhvilluar dhe shpërndarë materiale informative dhe duke organizuar fushata ndërgjegjësuese për shërbimet sociale publike që ata mund të përfitojnë.

Shërbimet sociale publike vendore duhet të jenë të lehtësisë së aksesueshme për subjektet e këtij plani. Kjo do të përmirësojë përgjigjen ndaj nevojave të diasporës dhe migrantëve, duke siguruar që ata të kenë qasje të barabartë në shërbimet dhe burimet që janë të disponueshme për komunitetin lokal. Në thelb, synohet të sigurohet një mjedis ku diaspora dhe migrantët të kenë qasje të lehtë në shërbimet dhe informacionin që ata kanë nevojë për t'u integruar në komunitetin lokal, duke ofruar mbështetje të përshtatshme.

Tabela 4: **Fusha e Veprimit B**

Fusha e veprimit B Shërbimet sociale publike me bazë komunitare.	**Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit:** Sigurimi i ofrimit të shërbimeve sociale dhe nevojave kryesore për të rikthyerit dhe diasporën në nivel vendor					
	Masat	**Afati**	**Institucioni përgjegjës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultatet e pritshme**	**Indikatorët e monitorueshëm**
Objektivi 2.1: Edukimi dhe informim i qëndrueshëm në lidhje me të drejtat dhe detyrimet.	a)Krijimi i një dritare të dedikuar për migrantët dhe diasporën në faqen web zyrtare të bashkisë.	2025 - 2027	BH	Zyra e IT dhe Komunikimit, organizata	Rritja e informimit dhe aksesit në shërbime	Dritarja ne Web, linku i faqes ku është përfshirë platforma e dedikuar.
	b) Hartimi, publikimi, shpërndarja e materialeve informuese.	2025 - 2027	BH	AKPA/DSHS /OSHC Organizata	Rritja e informimit dhe cilësise së shërbimeve ndaj qytetareve të rikthyer nga migracioni & diaspora	Materiale informuese të shpërndara
	c) Organizimi i takimeve periodike me organizata lokale që punojnë me target grupin e personave të rithyer nga migracioni me qellim zbatimin e programeve të përbashkëta për punësim dhe vetëpunësim.	2025 - 2030		Organizata/ AKPA/AKB		Nr i Takimeve
	d) Referimi i rasteve pranë institucioneve/drejtorive/strukturave të tjera vendore, në varësi të nevojës apo shërbimit të kërkuar	2025 - 2030	BH/SMD	DSHC/OSHC /Organizata	Shërbime dhe struktura të ngritura pranë Bashkisë Has, lidhur me regjistrimet e rasteve të referuara.	Databaze me të dhënat mbi rastet e referuara.

Objektivi 2.2: Sigurimi i shërbimeve sociale për përfshirjen dhe rintegrimin e migrantëve të kthyer dhe komuniteteve të diasporës	a) Ngritja dhe fuqizimi i grupit teknik lokal për riintegrimin e migrantëve të kthyer, me pjesëmarrje të gjithë strukturave të bashkisë që ofrojnë shërbime	2025 - 2030	BH	Organizata		GTR i ngritur me urdhër kryetari
	b) Referimi i emigrantëve të rikthyer për shërbime sociale, punësim, formim profesional.	2025 - 2030	BH/SMD	Shërbimi Social Shtetëror AKPA organizata	Rritja e nr te personave te rikthyer nga migracioni që referohen dhe marrin sherbime	Nr i personave të rikthyer nga emigracioni që kanë përfituar shërbime
	c)Hartimi i një udhërrëfyesi për shërbimet ofruara për migrantët e kthyer dhe procedura e aplikimit	2025		MB	Informacion i saktë dhe i validuar për emigrantët e rikthyer	1 dokument i hartuar
	d) Ofrimi i asistencës së dedikuar për aksesin në shërbimet publike nga eksperti i çështjeve gjinore në Bashki për gratë e rithyera nga emigracioni, persona që paraqesin vulnerabilitet	2026 - 2030	BH/ Sektori i ndihmës ekonomike dhe përkujdesjes shoqërore	Shërbimi Social Shtetëror Organizata		

FUSHA E VEPRIMIT C

Në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, qëllimi i planit është të identifikojë dhe të bëjë publike nevojat vendore për investime publike nga diaspora dhe migrantët e kthyer, të sigurojë mbështetje për realizimin e këtyre investimeve, dhe të lehtësojë procedurat për implementimin e tyre. Realizimi i këtyre objektivave do të arrihet nëpërmjet promovimit të të gjitha planeve strategjike të bashkisë Has, në mënyrë që të realizohet procesi njohës së nevojave për investime në përputhje me parashikimet në strategji më gjithpërfshirëse, duke respektuar përcaktimet e ndryshme ligjore. Këto proçese njohëse do të kryhen nëpërmjet takimeve të ndryshme më të gjithë aktorët e përfshirë, duke ju parashtruar informim dhe këshillim mbi kuadrin ligjor, institucional për zhvillimin e investimeve në Shqipëri.

Realizimi i investimeve në këtë kontekst, do të kryhet më së miri nëpërmjet përcaktimit të një procedurë më të thjeshtuar për donacionet nga diaspora, duke ofruar asistencë për plotësimin e dokumentacionit për aplikim, si dhe duke aplikuar masa lehtësuese në të gjitha fazat.



Tabela 5: **Fusha e Veprimit C**

Fusha e veprimit C	**Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit:**					
Zhvillimi dhe rritja e potencialit ekonomik të komunitetit lokal	Ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik vendor nga investimet konkrete të diasporës,					
	Masat	**Periudha e zbatimit**	**Institucioni përgjegjës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultatet e pritshme**	**Indikatorët e monitorueshëm**
Objektivi 3.1: Njohja dhe shpërndarja e nevojave vendore të komunitetit me diasporën dhe migrantët	a) Hartëzimi i nevojave konkrete (që nuk mbulohen nga bashkia) për investime në 4 njesitë administrative dhe komunikimi i tyre me komunitetin e diasporës	2025 - 2030	BH	Sektori i planifikimit të territorit dhe urbanistikës / Njesitë Administrative	Qartësimi i fushave që mund të kontribuojë diaspora nëpërmjet kryetareve të Njësivë Administrative dhe publikimi i tyre; 4 Prioritete të evidentuara në nivel Bashkie, të ndara në zona.	Harta e nevojave/ mundësive
	b) Zhvillimi i takimeve me donatorë (diasporë) për asistencën që mund të japin në mënyrë që të koodinohen nevojat dhe mundësitë	2025 - 2030				Dokumentimi i takimeve
Objektivi 3.2: Sigurimi i ndihmës për të përmirësuar investimet publike dhe private nga komuniteti diasporës dhe migrantët e kthyer	a) Asistencë e dedikuar tekniko-ligjore për investitorët potencialë të diasporës	2025 - 2030	Sektori Juridik/BH	AIDA	Person i dedikuar nga bashkia për suport	Nr i Investimve
	b) Hartimi i paketave informative mbi mundësitë e investimit dhe parashikimet ligjore	2025 - 2030		AIDA	Paketa informative të miratuara dhe të publikuara	

c) Miratimi i paketës fiskale të Bashkisë Has me lehtësime për kategorinë e diasporës dhe migrantëve	2026 - 2028	Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore	Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore, Këshilli Bashkiak	Parashikime në paketen fiskale vendore të miratuar	Vendimi Këshillit Bashkiak	i
d) Hartimi i një procedure standarte vendore për pranimin, përdorimin, raportimin dhe auditimin e fondeve të përfituara nga Disapora.	2025 - 2030	Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore	Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore/Këshilli Bashkiak	1 procedure standarte e hartuar	Miratimi procedurës	i

FUSHA E VEPRIMIT D

Në fushën e veprimtarive kulturore dhe artistike, ky plan ka objektiv kryesor promovimin e kontributit dhe të vlerave të diasporës në një nivel gjithpërfshirës. Objektiv i cili do të realizohet nëpërmjet organizimit të aktiviteteve, koncerteve, panaireve, me pjesëmarrjen e diasporës, si dhe realizimin e vizitave të ndryshme për mbrojtjen e identitetit dhe kulturës shqiptare në komunitetet shqiptare të diasporës.

Tabela 6: Fusha e Veprimit D

Fusha e veprimit D	Rezultatet e pritshme në fushën e veprimit:					
Veprimtaritë kulturore dhe artistike.	Përcjellja dhe ruajtja e traditave dhe kulturës Hasjane në diasporë.					
	Masat	**Periudha e zbatimit**	**Institucioni përgjegjës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultatet e pritshme**	**Indikatorët e monitorueshëm**
Objektivi 4.1: Promovimi i kontributit dhe vlerave të diasporës në fushën artistike dhe kulturore të vendit.	a) Organizimi i aktiviteteve, koncerteve, panaireve, pelegrinazhit me pjesmarrjën e diasporës.	2025 - 2030	BH/ Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë & Sportit.	AKD/Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë & Sportit.	Disa aktivitete në vit , të organizuar me mbështetjën e dhe pjesëmarrjen e diasporës.	Kalendar i eventeve me datat përkatëse; Foto nga aktivitetet.
	b) Realizimi i vizitave kulturore/shkëmbimeve në rajon dhe më gjerë.	2025 - 2030	BH/SMD	AKD/AMV	Shkëmbimi i eksperiencave në shërbim të ruajtjes së kulturës dhe traditave shqiptare/Hasjane.	Dokumentimi i takimeve dhe marrëveshjet e bashkëpunimeve.

MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT

Progresi në arritjen e objektivave do të matet nëpërmjet indikatorëve, të lidhur me objektiva dhe masa specifike, siç përcaktohet në Planin e Veprimit. Përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e përfundimit në kohë të secilës masë sipas sektorit dhe sipas parashikimit janë Nënkyetarët, Sekretarja e Përgjithshme, Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore, Sektori i Burimeve Njerëzore, Sektori Juridik, Sektori i ndihmës ekonomike dhe përkujdesjes shoqërore, Sektori i planifikimit të territorit dhe urbanistikës, Drejtoria e Arsimit, Kultures, Turizmit, Rinisë & Sportit dhe Specialisti/ja për Migracionin dhe Diasporën. Për këtë qëllim, do të krijohet një grup pune me urdhër të kryetarit të bashkisë Has, i cili do të përcaktojë formatin dhe procedurat për raportimin dhe mbajtjen e komunikimit të rregullt me të gjitha drejtoritë, agjencitë dhe institucionet e tjera përgjegjëse për zbatimin e masave.

Monitorimi i progresit të zbatimit të Planit të Veprimit do të kryhet nëpërmjet hartimit të raportimeve 6 mujore nga drejtoritë përgjegjëse për zbatimin e masave. Raportimet 6 mujore do të ndahen një herë në vit me gjithë institucionet lokale, qendrore edhe organizatat në një mbledhje të organizuar nga bashkia.

Gjetjet dhe rekomandimet mbi ecurinë e Planit të Veprimit adresohen në mbledhjet e Këshillit Bashkiak

